



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

P.nr. 78/2023

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, në çështjen penale kundër të pandehurve Xh.Sh dhe A.Lpër shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 lidhur me nën par.1 dhe nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK-së), të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2404/19 e datës 15.10.2020, duke vepruar në bazë të nenit 248 par.1 nën par. 1.4 të Kodit nr.08/L-032 të Procedurës Penale (tutje KPP), dhe neneve 14, 15, 17 te Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seancë me datë **14.03.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET** marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit me numër të lëndës në ndërmjetësim **ND.nr.65/2024 e datës 12.03.2024**, në mes të pandehurit Xh.SH, në njërin anë dhe të dëmtuarit V.B, në anën tjetër.
- II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2404/19 e datës 15.10.2020, dhe **PUSHOHET** procedura penale sa i përket të pandehurit i cili ka arritur marrveshje në procedurën e ndërmjetësimit, dhe atë për të pandehurin: 1. **Xh.Sh** nga i ati R. dhe e ëma S., i lindur me datë ... në P., me vendbanim në rr. "B.Gj" në P., me numër personal ..., shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës, aktualisht gjendet në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë për një vepër tjetër penale, i akuzuar për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 lidhur me nën par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së.
- Për shkak se i pandehuri Xh.Sh dhe i dëmtuari V.B, kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, e cila marrëveshje është aprovuar zyrtarisht nga gjykata.
- III. Marrëveshja e arritur** në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve si në pikën I, te këtij dispozitivi, është titull ekzekutiv sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
- IV.** Shpenzimet e kësaj procedurë penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Ar sy e t i m

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2404/19 të datës 29.02.2020, te cilën e ka përmirësuar me datë 15.10.2020, kundër të pandehurve Xh.Sh, V.H dhe A.L, për shkak se në bashkryerje kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe kundër të pandehurit V.B për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me aktvendimin e datës 07.03.2023, këtë çështje penale sa i përket të pandehurve Xh.Sh dhe A.L për veprën penale e cila ju vihet në barrë e ka veçuar nga çështja penale P.nr.90/20, për faktin se te njëjtit kanë qenë të paarritshëm dhe ndaj të njëjtve ka qenë aktiv urdherarresti për sigurimin e prezencës në gjykatë.

Gjykata me datë 07.03.2024, nga Stacioni Policor Veriu në Prishtinë, është njoftuar se është lokalizuar këtu i pandehuri Xh.Sh dhe i njëjti gjendet në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë

Gjykata pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, duke u bazuar në dispozitat e nenit 2, 4, 8 dhe 12 të Ligjit për Ndërmjetësim dhe nenin 229 par.1 dhe 2 të KPP-së, me Vendimin e **datës 12.03.2023**, këtë çështje penale e ka referuar në ndërmjetësim në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega Istog.

Gjykata me **datë 12.03.2024**, nga Qendra e Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega Istog, është njoftuar me:

- **Modelin e Marrëveshjes për Ndërmjetësim** (Shtojcën 2), sipas të cilës rezulton se palët e lartcekura si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi, janë pajtuar për ta zgjidhur kontestin e tyre në procedurën e ndërmjetësimit, dhe
- **Modelin e Marrëveshjes për Zgjidhjen e Ndërmjetësuar** (Shtojcën 3), sipas të cilës rezulton se ndërmjet palëve të lartcekura si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi është arritur marrëveshja në procedurën e ndërmjetësimit. E cila marrëveshje pasi që është nënshkruar nga ndërmjetësuesi, është proceduar në gjykatë te gjyqtari i çështjes për aprovim.

Gjykata me vendimin e **datës 12.03.2024** (shtojcën 5), e ka aprovuar marrëveshjen e arritur ne procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi, konform nenit 15 te Ligjit për Ndërmjetësim, e cila marrëveshje është dokument i ekzekutueshëm.

Sipas nenit 248 par. 1, nën par. 1.4 të KPP-së, përcaktohet se Gjykata e hedhë aktakuzën dhe e pushon procedurën kur: *“i pandehuri dhe i dëmtuari kanë lidhur marrëveshje ndërmjetësimi që është pranuar zyrtarisht nga gjykata”*.

Gjykata pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale i pandehuri Xhelal Shala në njëren anë dhe i dëmtuari Vilson Bajramaj, në anën tjetër, kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, e duke vlerësuar se marrëveshja e lidhur ne procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve është e paraparë dhe ne pajtim me Ligjin për Ndërmjetësim dhe dispozitat e

Kodit të Procedurës Penale, si dhe pas aprovimit të kësaj marrëveshje nga ana e Gjykatës, e duke vepruar konform nenit të sipërcituar 248 par. 1, nënpar. 1.4 të KPP-së, u vendos që të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale ndaj të pandehurit si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Ndërsa, gjykata me **datë 12.03.2024**, nga Qendra e Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega Istog, është njoftuar edhe me: **Raportin për mos fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, sa i përket të pandehurit A.L** për shkak të pamundësisë së sigurimit të prezencës se tij në seancën e ndërmjetësimit, ngase ndaj të njëjtit është i lëshuar edhe urdherarrest. Pastaj, gjykata pasi ka aprovuar marrëveshjen e arritur ne procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve - të pandehurt Xh.Sh në njërën anë dhe të dëmtuarit V.B në anën tjetër, dhe pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në pajtim me nenin 35 të KPP-së dhe përshtatshmërisht edhe me nenin 242 par.8 nënpar.8.2 të KPP-së, me aktvendimin e datës 12.03.2024, ka bërë veçimin e kësaj procedurë penale ne raport më të pandehurin A.L, i cili nuk ka arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, e cila lëndë e veçuar ndaj tij do të evidentohet me numër të ri të lëndës sipas regjistrit të kësaj gjykate fizik dhe elektronik.

Konstatimi në pikën III, të dispozitivit të këtij aktvendimi, se marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve në këtë çështje penale, është titull ekzekutiv sipas legjislacionit përkatës në fuqi, bazohet në nenin 229 par.6 të KPP-së.

Gjykata vendimin në pikën IV, të dispozitivit të këtij aktvendimi, lidhur me shpenzimet e kësaj procedure penale e ka marrë konform nenit 453 par.1 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë, në bazë të neni 248 par.1 nën par. 1.4 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej tri (3) ditësh, nga dita e pranimit, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. *Në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.*